



# Buletini Mjedisor

## SHQIPËRIA MË E PASTËR SE NJË VIT MË PARË

### NGA INTERPELANCA PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE



Fusha e mbetjeve ngelet ende në vëmendje jo vetëm të

Ministrit të Mjedisit, por dhe të përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvendin e Shqipërisë.

Deputetja e prefekturës së Lezhës Znj. Monika Kryemadhi kishte kërkuar interpelancë të Ministrit të Mjedisit në lidhje me gjendjen e përpunimit e mbetjeve urbane dhe problemeve mjedisore që kanë shkaktuar ato në kohët e fundit në disa komuna të vendit.

Duke analizuar punën e bërë gjatë një viti në fushën e menaxhimit të mbetjeve, Ministri i Mjedisit u ndal në disa nga masat marra. “Gjatë këtij viti u ndalua importimi i mbetjeve, ligji nr. 156 datë 10.10.2013 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’. U ngrit Komiteti Ndërmëtor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, që më 5 shkurt 2014, shpalli

gjendjen e Emergjencës Mjedisore, që pasoi me ngritjen e një Task Force të kryesuar nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, duke kthyer në një realitet ndryshe akset kombëtare, po qoftë edhe pikat hyrëse dhe bregdetin shqiptar. Ndaj, unë besoj sot se çdokush mund të japë të njëjtën përgjigje si unë, që Shqipëria është më e pastër”, tha ndër të tjerash Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka.

### RISITË NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Në vazhdimësi të hapave të përmendura më lart këtë fundmuaj filloi projekti i ndarjes së mbetjeve në burim në institucionet shtetërore dhe institucionet arsimore universitare.



Ministria e Mjedisit, mbështetur edhe në Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, po implementon projektin që do të mundësojë reduktimin e sasisë së

mbetjeve që shkojnë në landfill.

Projekti ka gjetur mbështetjen financiare të Qeverisë Italiane dhe do të shtrihet në të gjitha institucionet qendrore dhe të varësisë, si dhe institucionet arsimore publike për Qarkun e Tiranës.

Në këto institucione mbetjet do të mblidhen në mënyrë të diferencuar: letër, plastika dhe materialet e aluminit (kanaçe), këto lloj mbetjesh nuk do të hidhen më në landfill, por do t'i kalojnë biznesit riciklues në Shqipëri, prej të cilës përfitohet lëndë e parë, për prodhimin e elementëve të tjerë të kërkuara në treg. Ky është hapi i parë i ciklit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ditët e fundit, Ministri i Mjedisit informoi publikun se së shpejti Shqipëria do ketë insenerator, ndërtimi i të cilit është zgjidhja e duhur për mbetjet në fundin e ciklit të tyre.

Ndërtimi i një inseneratori plotëson të gjithë ciklin e menaxhimit të mbetjeve, në mënyrë të integruar, gjë që mundëson aplikimin e shkallëve hierarkike të mbetjeve në vendin tonë.

## VAZHDON NDËSHKIMI PËR SHKELËSIT E LIGJIT



Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU) ka nisur aksionin për kontrollin e kompanive që shfrytëzojnë inertet e lumenjve

Gjatë aksionit në gjashtë basenet e lumenjve, u konstatuan 8 subjekte që ushtronin aktivitet të jashtëligjshëm në basenin e Vjosës dhe Semanit, në

qarkun e Fierit.

Ndaj këtyre subjekteve, Inspektoriati mori masën e pezullimit të aktivitetit, si edhe vendosjen e gjobave me 2 milionë lekë të reja për secilën prej tyre.

Deri tani ISHMPU - ja ka gjobitur dhe pezulluar 65 subjekte, të cilat nuk kishin as leje mjedisore dhe as leje për ushtrimin e aktivitetit të tyre.

Vendosja e gjobës dhe pezullim të aktivitetit është marrë edhe për 13 subjekte, të cilat kishin leje për të zhvilluar aktivitetin e tyre për të

rregulluar shtratin e lumenjve Drin, Mat dhe Bunë, leje që nuk e kishin zbatuar.

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, në rang vendi ka evidentuar 155 subjekte të kundraligjshëm.

Verifikimi i subjekteve vijon ndërkohë që ISHMPU-ja po përgatit dosjet e plota të subjekteve, të cilat do t'i përcillen strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme për marrjen e masave të mëtejshme.

### NË KËTË NUMËR:

SHQIPËRIA MË E PASTËR SE NJË VIT MË PARË FQ.1

LEJET MJEDISORE SHTATOR 2014 FQ.2-3

VUOINË TRAINIMET E STRUKTURAVE TË VARËSISË FQ.3

AKTIVITETET NGA AGENSIA E MJEDISIT FQ.4

*“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e Mjedisit dhe pyjeve, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Përmbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkëvenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillim e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.*

## LEJET MJEDISORE SHTATOR 2014

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	Besa Gaz	Depozita gazi	Synej, Kavajë	VNM-Paraprake
2	IB Recycling	Demontim marmitash katalitike	Bisht Kamëz, Durrës	VNM-Paraprake
3	Brajan 2013	Shfrytëzim kromi	Laku i Rrepës, Lezhë	Refuzim
4	HEC Quku	HEC	Quk, Librazhd	VNM-Paraprake
5	Imi Farma	Linjë prodhimi farmaceutike	Xhafzotaj, Durrës	VNM-Paraprake

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	SECURITY FORCE - 98	Linjë prodhimi dhe ambalazhimi të ujit Aqua Prima, (Burimi Selita) dhe pijeve joalkolike	Lanabregas, Tiranë	VNM-Paraprake
2	KRYPI - ABA	Veprimtari e nxjerrjes së mineralit të kromit	Komuna Martanesh, Dibër	VNM-Thelluar
3	FB ART	Godinë banimi dhe shërbimesh 1-7-8-9 kate me 3 kate nëntoke	Rruga "Muhamet Gjollësia", Tiranë	Refuzim
4	LETER - PLAST IMERAJ	Përpunim i letërës dhe granulim i plastikës	Kamëz, Tiranë	Refuzim
5	LIM - EM	Godinë banimi dhe shërbimesh 4-6 kate mbi tokë me 2 kate parkim nëntoke	Laparakë, Tiranë	Refuzim
6	SKATINE- HEC	Ndërtim dhe funksionim i hidrocentralit "SKATINE" në rrjedhën e përroit të Skatinës	Bytyc, Tropojë, Kukës	Deklaratë Mjedisore
7	NISATEL	Ndërtim infrastrukture me fibra optike	Orikum, Vlorë	VNM-Paraprake

### I KTHEHET GJELBËRIMI ZONËS PËRRETH BOVILLËS



Prej muajsh Ministria e Mjedisit ka fokusuar punën e saj në përmirësimin e infrastrukturës dhe gjendjes së Parqeve Kombëtare dhe Zonave të mbrojtura. Ky projekt është në vijim të shumë projekteve të tjera rehabilituese që Ministria e

Filloi puna për rehabilitimin e zonës përreth Bovillës, pjesë e Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit" në rrethin e Krujës. Mjedisit ka ndërmarrë kohët e fundit në Parqe Kombëtare dhe në Zona të Mbrojtura. Rehabilitimi i basenit të Bovillës ka një rëndësi të jashtëzakonshme pasi mjedisi përreth ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e ujit të pijshëm për banorët e kryeqytetit.

Rehabilitimi konsiston në ripëllëzimin e 25 hektarëve me lloje të pishave mesdhetare, plot 63 mijë fidanë. Ripëllëzimi do të kryhet brenda sipërfaqes së Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit", pjesa e rrethit të Krujës, kryesisht në zonën e Bovillës. Mbjellja e fidanëve ka për qëllim mbrojtjen e basenit ujëmbledhës të Bovillës dhe

përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm për banorët e qytetit të Tiranës dhe të zonave përreth. Mbjellja e fidanëve 2 vjeçarë do të mbarojë në fund të muajit nëntor.

Zona rreth basenit ujëmbledhës së Bovillës është degraduar vit pas viti, si nga erozioni, ashtu edhe nga prerjet e paligjshme të druve. Ripëllëzimi i saj me fidanët e rinj të pishave mesdhetare do të bëjë që në të ardhmen të shmangët një nga nga problematikat kyçe të kësaj zone me rëndësi të veçantë.

## LEJET MJEDISORE SHTATOR 2014

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	Alba Konstruksion	Ndërtim godinash banimi	Bashkia Tiranë	Refuzim
2	Alb-Millenum 7171	Ndërtim godinash banimi	Bashkia Tiranë	Refuzim
3	Alb-Millenum 7284	Ndërtim godinash banimi	Bashkia Tiranë	Refuzim
4	Mason	Ndërtim godinash banimi	Bashkia Tiranë	Refuzim
5	Oil Palmir	Rafineri naftë	Patos, Fier	Deklaratë Mjedisore

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	BASHKIA MAMURRAS	Rikonstruksion i rrugës Lagjia Demokracia dhe rrugicës së Xhetaneve	Mamurras, Lezhë	Miratim
2	ZBOGO-JA	Objekt banimi dhe shërbimi 1, 6 dhe 7 kate me 3 kate parkim nentokë	Tiranë	Refuzim
3	TOPI EKI	Shfrytëzim guri gëlqeror të mermerizuar me punime sipërfaqësore	Skrapar, Berat	Deklaratë Mjedisore
4	STARDUS	Shfrytëzim minerali hekur-nikel	Surroj, Kukës	Deklaratë Mjedisore
5	AYEN AS ENERGJI 6979	Linja elektrike e tensionit të lartë 2 x 220 kv me gjatësi linje 2000 m për lidhjen e nënstacionit të HEC-it Peshqesh me linjë ekzistuese Fierzë-Burrel	Mirditë, Peshqesh, Lezhe	VNM-Paraprake
6	AYEN AS ENERGJI 6977	Linja elektrike e tensionit të lartë 2 x 220 kv me gjatësi linje 1081 m për lidhjen e nënstacionit të HEC-it Fang me linjë ekzistuese Fierzë - Tiranë	Mirditë, Fang, Lezhë	VNM-Paraprake

## VIJOJNË TRAJNIMET E STRUKTURAVE TË VARËSISË



e varësisë ARM, ISHMPU rajonale, si dhe ekspertet mjedisore.

Takimi i radhës u zhvillua ditën e djeshme, më 28 Tetor 2014 në prefekturën e Fierit. Takimi u hap nga Drejtori i Drejtorisë së Mjedisit, i cili i konsideroi si mjaft të nevojshme këto trajnime që po ndërmerren në të gjithë vendin në kuadër të programit të 300 ditëshit, pasi do të ndihmojnë në punën e tyre ARM, ISHMPU rajonale, ekspertet

mjedisore dhe bizneset, në lidhje me procedurat e VNM dhe lejeve të Mjedisit, si dhe me legjislacionin e ri të miratuar për këto fusha. Në këtë takim pati përfaqësues nga ARM dhe ISHMPU-ja e Fierit. Gjithashtu pati prezencë dhe nga pushteti vendor i qytetit të Fierit dhe Patosit.

Pas fjalëve hapëse, përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit u prezantuan të pranishmëve procedurat për t'u pajisur me Leje Mjedisit për aktivitetet që kanë ndikim mjedisor, si dhe me legjislacionin e ri në fushën e Mjedisit. Modulet e prezantuara janë me tematikat e mëposhtme:

Zbatimin e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

(VNM);

Zbatimin e legjislacionit në fuqi për Lejet e Mjedisit;

Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për zbatimin e Konventës ESPOO (Për miratimin e rregullave dhe procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar-ESPOO);

Procedurat e konsultimit ndërinstitucional dhe me publikun gjatë zhvillimit të procesit të VNM-së dhe ESPOO-s;

Në këtë trajnim pati pjesëmarrje aktive, sidomos në lidhje me procedurat për t'u pajisur me leje mjedisit për aktivitetet që kanë ndikim mjedisor.

